



Date: 24.04.2025
Numër Protokoli: 2730/2025

A.nr.446/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar Malsore Gashi–Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi-në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.446/2025 të datës 11.03.2025 e parashtruar nga ankuesi Arben Latifi, kundër organit të punësimit/ Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “Shkelje e të drejtës në pagë”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 24.04.2025, mori këtë;

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.446/2025 e datës 11.03.2025 e parashtruar nga ankuesi Arben Latifi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, Arben Latifi (tutje referuar vetëm Ankuesi), më datë 11.03.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1588/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Zyrtares Publik dhe Ligjit për pagat e Sektorit Publik, jam i diskriminuar me punën që bëje dhe pagën që marr dhe se Ministria e Punëve të Brendshme/Agjencia për Regjistrimin Civil, ka shpallur konkurs dhe ka rekrutuar zyrtar për punë të njëjte me pagë të lartë, ndërsa unë që punoj paguhem me koeficient 4.5, e që është shkelje e rendë ligjore, sepse është dashtë të behët nivelizimi i pagave paraprakisht për zyrtaret që janë në marrëdhënie pune pas hyrjes në fuqi, të këtyre dy ligjeve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.03.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Këshilli më datën 04.04.2025, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve e Brendshme me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 1588/2025 të datës 11.03.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopje e letërnjoftimit për A.L; Akt Emërimi

Nr. Ref;DRGJC/ARC -6/13, i datës 31.01.2013; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.03.2025, e dërguar përmes emalit nga R.K, për A.G; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 446/2025, e datës 04.04.2025; Përshkrimi i Detyrave të Punës; Listat e pagave nga muaji janar deri në muajin dhjetor të vitit 2023, për ankuesin A.L; Listat e pagave nga muaji janar deri në muajin dhjetor të vitit 2024, për ankuesin A.L; Lista e pagave për muajin janar dhe shkurt e vitit 2025, për ankuesin A.L.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesi, konstatoi se ankesa është e parakohshme, sepse:

Nga provat e lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt Emërimit me numër Nr. Ref; DRGJC/ARC -6/13, i datës 31.01.2013, është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme/ Agjencia e Regjistrimit Civil, dhe se i njëjti mbanë pozitën e punës “ Nëpunës Administrativ në QKRC, në Podujevë.

Më datë 11.03.2025 ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Zyraret Publik dhe Ligjit për pagat e Sektorit Publik, jam i diskriminuar me punën që bëje dhe pagën që marrë.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: ”1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitive të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitive të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Ministria e Punëve të Brendshme/ Agjencia e Regjistrimit Civil, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procedimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, (e aplikueshëm deri me datë 21.02.2024), por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë

Andaj, duke qenë se organi përkatës i punësimit nuk ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës sikurse përcaktohej me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Vendimin Nr. 04/128 të datës 16.02.2023 dhe Vendimit Nr.17/162 të datës 27.09.2023, Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku institucionet e administratës publike kanë qenë të obliguara të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitive të punës me se voni deri me datë 31.12.2023, Kolegji i Këshillit duke iu referuar dispozitave të nenit 34 të Rregullores (QRK)

Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, në fuqi nga data 22.02.2024, thekson faktin se institucionet janë të obliguara që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, pra deri me 22.05.2024, andaj, mbi këtë bazë, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankuesit, për kategorizimin e pozitës së tij, është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritior. Rrjedhimisht, e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës se theksuar më lart, ankuesit do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tyre të punës.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Këshillë Juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS **Lënda me numër A.nr.446/2025**

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.L;
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.